



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
DPK	03-02/3455/1
Nr. ffaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	24.10.2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2522/17, për znj. Diana Hajdari, Këshilltare Komunale në Komunën e Gjakovës, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Diana Hajdari, Këshilltare Komunale në Komunën e Gjakovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private B.I "Diana Hajdari" dhe Sh.P.K "Ortec", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Hajdari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja e lartë është njoftuar me fakte se ushtrimi i funksionit menaxhues në biznes privat është i ndaluar neni (15 paragrafi 1) të Ligjit nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarja e lartë, është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresat zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3352/17) (DPKI.03-02/3353/17) me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë është larguar nga funksionet “person i autorizuar” në bizneset private të cekura më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

